


# Produkti i Brendshëm Bruto, 2015

## Vlerësime paraprake 2015

**Tiranë, më 13 Dhjetor 2016:** INSTAT paraqet për përdoruesit të dhënat vjetore paraprake të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), për vitin 2015.

Në vitin 2015 ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma realë (në volum) prej +2,59 % krahasuar me vitin 2014, pas një rritje prej +1,83 % në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013.

Fig 1. PBB dhe rritja ekonomike, 2010 - 2015



Sipas të dhënave me baza vjetore, PBB me çmime korrente në vitin 2015 u vlerësua 1.434.740 milion lekë (10.3 miliardë Euro) dhe 1.394.419 milionë lekë (10.0 miliardë Euro) për vitin 2014. PBB për frymë në vitin 2015 arriti në 497 mijë lekë (ose 3.554 €) nga 482 mijë lekë (ose 3.443 €) që ishte në vitin 2014.


Tab.1 Treguesit kryesore makroekonomike (2014-2015 me çmime korente)

Treguesit	Vitet		
	2014*	2015**	
Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korente (në milion lekë)	1.394.419	1.434.740	
Të ardhurat kombëtare bruto (në milion lekë)	1.377.713	1.413.939	
Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)	1,83	2,59	
Deflatori i PBB (në %)	1,4	0,3	
Popullsia mesatare vjetore (në mijë banorë)	2.894	2.889	
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Mijë lekë	482	497
	EURO	3.443	3.554
	USD	4.569	3.942

2014\* Të dhëna gjysëm-finale / 2015\*\* Të dhëna paraprake

Sipas *PBB-së me metodën e prodhimit*, kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët e ekonomisë si “Ndërtimi” me 1.23 pikë përqindje, “Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative” me 0,67 pikë përqindje, “Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia” me 0,33 pikë përqindje, “Arte, argëtim dhe shërbimet e tjera” me 0,16 pikë përqindje, “Aktivitete financiare dhe sigurimi” me 0,13 pikë përqindje, “Informacioni dhe komunikacioni” me 0,13 pikë përqindje, dhe “Aktivitete të pasurive të paluajshme” me 0,07 pikë përqindje. “Tregti, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor” është grupi i aktiviteteve që ka kontribuar negativisht në rritjen ekonomike me -0,09 pikë përqindje. Taksat neto mbi produktet kontribuuan respektivisht me -0,23 pikë përqindje.

**Fig 2. Kontributi i degëve kryesore të ekonomisë në normën reale të rritjes së PBB 2015, në pikë përqindje**



Përsa i përket strukturës së PBB sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2015 vazhdojnë ta zënë *Shërbimet* gjithsej me 46,3 % të PBB, të cilat u rritën me +3,03 % në terma realë. *Industria dhe Ndërtimi* përbëjnë 21,4 % të Produktit të Brendshëm Bruto, por ndërsa *Industria* u rrit me +0,34 % në volum, *Ndërtimi* ka pësuar një rritje prej +14,12 %. *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* përbëjnë 20,3 % të PBB dhe janë rritur me +0,79 % në terma realë.


Deflatori i PBB-së për vitin 2015 ishte +0,3 %.

Sipas *PBB-së me metodën e shpenzimeve*, *Konsumi final*, komponenti me peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi (92,66 %), u rrit me një normë rritje +2,48 % në terma nominalë dhe +0,75 % në terma realë. Në strukturën e Konsumit Final është *konsumi final i popullatës* ai që zë peshën më të madhe, prej 80,93 %, i ndjekur nga *konsumi i administratës publike* me 11,20 % dhe *konsumi i institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve (JFSSF)* me 0,53 %.

Në vitin 2015, *Formimi bruto i kapitalit fiks* i cili përbën 26,31 % të PBB-së, u rrit me + 10,12 % në terma nominalë dhe +10,35 % në terma realë, krahasuar me vitin 2014.

*Eksportet e mallrave dhe shërbimeve* u ulën me 0.65% në terma nominalë dhe pësuan një rritje të lehtë me 0,99 % në terma realë, ndërkohë që *Importet e mallrave dhe shërbimeve* u ulën me -3,00 % në terma nominalë dhe u ulën me -3,15 % në terma realë, krahasuar me vitin 2014.

Fig 3. Struktura e PBB me metodën e Shpenzimeve, në %



**Tab2. Treguesit ë ekonomikë sipas aktiviteteve ekonomike, grupimi A10**

A10	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 2	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)	Struktura e PBB (%)		Kontributi
		2014*	2015**	2015**	2015**	2014*	2015**	2015**
A1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	278.924	291.601	281.124	0,79	20,0	20,3	0,16
A2	Industria gjithsej	178.543	168.275	179.151	0,34	12,8	11,7	0,04
2a	nga cila: Industria përpunuese	73.603	77.396	77.290	5,01	5,3	5,4	0,26
A3	Ndërtimi	121.402	138.658	138.539	14,12	8,7	9,7	1,23
A4	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	220.230	220.335	218.943	-0,58	15,8	15,4	-0,09
A5	Informacioni dhe komunikacioni	38.849	41.237	40.614	4,55	2,8	2,9	0,13
A6	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	35.160	38.975	36.956	5,11	2,5	2,7	0,13
A7	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	85.816	85.905	86.739	1,08	6,2	6,0	0,07
A8	Aktivitete shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse	70.390	81.230	79.736	13,28	5,0	5,7	0,67
A9	Administrata publike;Arsimi; Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	155.059	161.602	159.657	2,97	11,1	11,3	0,33
A10	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi	32.560	34.926	34.778	6,81	2,3	2,4	0,16
	<b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>	<b>1.216.933</b>	<b>1.262.744</b>	<b>1.256.238</b>	<b>3,23</b>	<b>87,3</b>	<b>88,0</b>	<b>2,82</b>
	Taksa neto mbi produktet	177.487	171.996	174.290	-1,80	12,7	12,0	-0,23
	<b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>	<b>1.394.419</b>	<b>1.434.740</b>	<b>1.430.528</b>	<b>2,59</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>2,59</b>

2014\* Të dhëna gjysëm-finale

2015\*\* Të dhëna paraprake

**Tab.3 Indekset e rritjes në vlerë dhe struktura e PBB me çmimet e tregut, 2014-2015**

A19	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 2	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Indeksi i rritjes nominale (%)	Struktura e PBB (%)	
		2014*	2015**		(2015/2014)	2014*
A1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	278.924	291.601	4,55	20,0	20,3
A2	Industria nxjerrëse	69.085	43.106	-37,60	5,0	3,0
A3	Industria përpunuese	73.603	77.396	5,15	5,3	5,4
A4	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	25.850	36.853	42,57	1,9	2,6
A5	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	10.005	10.920	9,14	0,7	0,8
A6	Ndërtimi	121.402	138.658	14,21	8,7	9,7
A7	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave	154.294	151.276	-1,96	11,1	10,5
A8	Transporti dhe magazinimi	41.594	43.890	5,52	3,0	3,1
A9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	24.342	25.168	3,39	1,7	1,8
A10	Informacioni dhe komunikacioni	38.849	41.237	6,15	2,8	2,9
A11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	35.160	38.975	10,85	2,5	2,7
A12	Aktivitetet e pasurive të paluajtëshme	85.816	85.905	0,10	6,2	6,0
A13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	35.098	41.206	17,40	2,5	2,9
A14	Shërbime administrative dhe mbështetëse	35.292	40.024	13,41	2,5	2,8
A15	Administrim publik dhe mbrojtja social e detyrueshëm	57.149	59.266	3,70	4,1	4,1
A16	Arsimimi	59.797	61.179	2,31	4,3	4,3
A17	Shëndetsia dhe aktivitetet e punës sociale	38.114	41.158	7,99	2,7	2,9
A18	Arte, argëtim dhe çlodhje	17.121	16.761	-2,10	1,2	1,2
A19	Aktivitetet të tjera shërbimi	15.439	18.165	17,65	1,1	1,3
	<b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>	<b>1.216.933</b>	<b>1.262.744</b>	<b>3,76</b>	<b>87,3</b>	<b>88,0</b>
	Taksa neto mbi produktet	177.487	171.996	-3,09	12,7	12,0
	<b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>	<b>1.394.419</b>	<b>1.434.740</b>	<b>2,89</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>

2014\* Të dhëna gjysëm-finale

2015\*\* Të dhëna paraprake

**Tab.4 PBB me çmimet korente, të vitit të mëparshëm dhe ritja reale vjetore, 2014-2015**

A19	Treguesit	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)
		2014*	2015**	2015**	2015**
A1	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	278.924	291.601	281.124	0,79
A2	Industria nxjerrëse	69.085	43.106	61.324	-11,23
A3	Industria përpunuese	73.603	77.396	77.290	5,01
A4	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	25.850	36.853	29.372	13,62
A5	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	10.005	10.920	11.164	11,58
A6	Ndërtimi	121.402	138.658	138.539	14,12
A7	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave	154.294	151.276	149.160	-3,33
A8	Transporti dhe magazinimi	41.594	43.890	44.737	7,56
A9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	24.342	25.168	25.046	2,89
A10	Informacioni dhe komunikacioni	38.849	41.237	40.614	4,55
A11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	35.160	38.975	36.956	5,11
A12	Aktivitetet të pasurive të paluajtëshme (real estate)	85.816	85.905	86.739	1,08
A13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	35.098	41.206	40.449	15,25
A14	Shërbime administrative dhe mbështetëse	35.292	40.024	39.287	11,32
A15	Administrim publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	57.149	59.266	58.392	2,18
A16	Arsimimi	59.797	61.179	59.621	-0,29
A17	Shëndetsia dhe aktivitetet e punës sociale	38.114	41.158	41.643	9,26
A18	Arte, argëtim dhe çlodhje	17.121	16.761	16.848	-1,59
A19	Aktivitetet të tjera shërbimi	15.439	18.165	17.930	16,13
	<b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>	<b>1.216.933</b>	<b>1.262.744</b>	<b>1.256.238</b>	<b>3,23</b>
	Taksa neto mbi produktet	177.487	171.996	174.290	-1,80
	<b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>	<b>1.394.419</b>	<b>1.434.740</b>	<b>1.430.528</b>	<b>2,59</b>

2014\* Të dhëna gjysëm-finale

2015\*\* Të dhëna paraprake

**Tab. 5 Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve, me çmime korrente**

Treguesit e PBB-së	Vlerat me çmime korrente		Indeksi i rritjes nominale (%)	Struktura e PBB (%)	
	Në Milion Lek			2014*	2015**
	2014*	2015**	(2015/2014)	2014*	2015**
<b>Konsumi Final</b>	1.297.286	1.329.469	2,48	93,03	92,66
<b>Konsumi Final i Popullatës</b>	1.129.915	1.161.195	2,77	81,03	80,93
<b>Konsumi Final i Administratës Publike</b>	159.788	160.711	0,58	11,46	11,20
Konsumi Individual	80.060	78.375	-2,10	5,74	5,46
Konsumi Kolektiv	79.729	82.336	3,27	5,72	5,74
<b>Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse</b>	7.583	7.562	-0,27	0,54	0,53
<b>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks</b>	342.844	377.538	10,12	24,59	26,31
<b>Ndryshimet e gjëndjeve</b>	31.154	-24.617		2,23	-1,72
Mospërputhje statistikore	-12.010			-0,86	
<b>Eksporti neto</b>	-264.855	-247.651	-6,50	-18,99	-17,26
<b>Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	393.657	391.098	-0,65	28,23	27,26
Eksportet e mallrave	130.401	107.849	-17,29	9,35	7,52
Eksportet e shërbimeve	263.257	283.249	7,59	18,88	19,74
<b>Importet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	658.512	638.749	-3,00	47,22	44,52
Importet e mallrave	440.461	428.797	-2,65	31,59	29,89
Importet e shërbimeve	218.051	209.951	-3,71	15,64	14,63
<b>PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO</b>	<b>1.394.419</b>	<b>1.434.740</b>	<b>2,89</b>	<b>100,00</b>	<b>100,00</b>

2014\* Të dhëna gjysëm-finale

2015\*\*Të dhëna paraprake

Tab.6 Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve me çmimet e vitit të mëparshëm

Treguesit e PBB-së	Vlerat me çmime korente		PBB me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)
	Në Milion Lek			
	2014*	2015**	(2015/2014)	2015**
<b>Konsumi Final</b>	1.297.286	1.329.469	1.307.023	0,75
<b>Konsumi Final i Popullatës</b>	1.129.915	1.161.195	1.140.097	0,90
<b>Konsumi Final i Administratës Publike</b>	159.788	160.711	159.360	-0,27
Konsumi Individual	80.060	78.375	78.311	-2,18
Konsumi Kolektiv	79.729	82.336	81.048	1,65
<b>Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse</b>	7.583	7.562	7.566	-0,21
<b>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks</b>	342.844	377.538	378.318	10,35
<b>Eksporti neto</b>	-264.855	-247.651	- 240.228	9,30
<b>Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	393.657	391.098	397.562	0,99
Eksportet e mallrave	130.401	107.849	108.154	-17,06
Eksportet e shërbimeve	263.257	283.249	289.408	9,93
<b>Importet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	658.512	638.749	637.790	-3,15
Importet e mallrave	440.461	428.797	430.499	-2,26
Importet e shërbimeve	218.051	209.951	207.291	-4,93
<b>PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO</b>	1.394.419	1.434.740	1.430.528	2,59

2014\* Të dhëna gjysëm-finale

2015\*\* Të dhëna paraprake



# Informacion për përdoruesin

## Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Europian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993.

Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit ose një tre-mujor). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomeklatura e veprimtarive ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomeklatura e produkteve (NP);
- Klasifikimi i konsumit individual sipas perdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

## Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe të tjera. Duke krahasuar këto burime me njera-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, konsistente, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruara nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa e Forcave të Punës; Anketa të matjes së nivelit të jetesës; Anketa të Statistikave të Çmimeve, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Statistika financiare monetare; Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të qeverisë; Statistika të tregtisë së jashtme; Të dhëna mbi energjinë elektrike dhe të produkteve energjitike; etj.

**Fazat e publikimit dhe Politikat revizionuese**

Vlerësimet e PBB-së vjetore kalojnë në tre faza llogaritjesh dhe publikimesh.

- Faza e parë është llogaritja paraprake vjetore e PBB të vitit (t) sipas të dyja metodave brenda njëmbëdhjetë muajve pas përfundimit të vitit (t+11) dhe bazohet në burime të të dhënave paraprake të Anketës Vjetore Strukturore pranë Ndërmarrjeve dhe burime administrative.
- Faza e dytë përfshin vlerësimet gjysëm-finale të llogarive vjetore të PBB të vitit "t" brenda gjashtë muajve pas vlerësimit paraprak (t+17). Llogaritjet gjysëm-finale bazohen në burime të dhënash më të plota dhe si rrjedhojë pothuajse tërësisht në metoda të drejtpërdrejta.
- Faza e tretë përfshin vlerësimet finale të PBB të vitit (t). Në këtë fazë të tretë rishikohen dhe njëherë të dhënat e vitit (t) kur vjen seti i të dhënave për vitin (t+1) me qëllim që të përfshihet çdo ndryshim i bërë për vitin (t) dhe të sigurohet konsistenca midis dy viteve të njëpasnjëshëm. Gjatë kësaj faze bëhet dhe balancimi final në nivel produkti midis dy metodave të PBB-së.

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe të veçanta.

*Revizionime të zakonshme:*

Revizionimet e zakonshme të PBB-së me baza vjetore janë rezultat i përditësimeve dhe plotësimit të burimeve ekzistuese të të dhënave me informacionin më të fundit për një vit të caktuar "t". Vlerësimet e PBB-së për vitin "t" kalojnë në tre fazat e mësipërme të llogaritjeve dhe publikimeve. Vlerësimi i parë me baza vjetore të PBB (paraprake/flash) (viti t) është njëmbëdhjetë muaj (në fillim të Dhjetorit të vitit (t+1)). Vlerësimi mbështetet në të dhënat paraprake nga anketat dhe në disa raste në burime të tjera administrative. Një vlerësim i tillë rishikohet pas gjashtë muajsh në mënyrë që të marrim një vlerësim gjysëm-final. Në këtë moment rishikohen gjithashtu edhe vlerësimet e vitit të kaluar (t-1) për t'i kaluar nga vlerësime gjysëm-finale në finale.

*Revizionime të veçanta:*

Revizionimet e veçanta vijnë si rezultat i përfshirjes së burimeve të reja të të dhënave statistikore e administrative dhe përmirësimi i atyre ekzistuese; përmirësimi të teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare; ndryshimit të metodologjisë për shkak të standarteve të reja të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA dhe ESA).

**Përkufizime**

**Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB):** Prodhimi i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:

- **PBB me mënyrën e prodhimit,** është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektorëve apo degëve të aktivitetit);

- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fiks, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

**Prodhimi:** Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

**Konsumi i ndërmjetëm:** Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks.

**Vlera e shtuar bruto:** Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

**PBB nominal** mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

**PBB reale** mat produktin total të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, por duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (të dhënë-mundet me qene viti paraardhës ose cili vit caktohet si vit bazë).

**Taksat mbi produktet dhe importin:** Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

**Subvencione në produkte:** Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësive institucionale rezidente.

**Konsumi Final:** Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

**Konsumi final i familjeve:** Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

**Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse:** Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHF dhe vlerës së prodhimit tregtar.

**Eksporti neto:** Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

**Formimi Bruto i Kapitalit Fiks:** Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

**Ndryshimi i gjendjeve:** Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë, etj.

**Çmim bazë:** Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

**Çmimet e tregut:** janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

**Çmime korente:** Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

**Çmime konstante:** Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale pra të korigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.